



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 299, Datë 19.10.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “TRUEN” SH.P.K. PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT
NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1959/9 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “TRUEN” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 30.01.2013, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 12, datë 30.01.2013.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1959 prot., datë 24.07.2023 dhe nr. 1959/1 prot., datë 03.08.2023, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat esaj, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 51 % të kuotave të zotëruara nga ortaku i shoqërisë “CN’AIR” te ortaku tjetër i shoqërisë “YLLIAD”, i cili zotëron 49 % të kuotave dhe me këtë transferim bëhet ortak me 100 % të kuotave.
- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1959/2 prot., datë 16.08.2023, iu evidentua shoqërisë dhe dokumentacioni i munguar për këtë aplikim. Shoqëria

e shkresën e protokolluar në ERE me nr. 19593 prot., datë 28.08.2023, ka kërkuar nga ERE më shumë më kohë në dispozicion për plotësimin e këtij dokumentacioni, ndërsa me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1959/5 prot., datë 12.09.2023, nr. 1959/7 prot., datë 28.09.2023 dhe nr. 1959/8 prot., datë 06.10.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1 (gërmat a, b, c, d, e dhe f) dhe pika 2 (gërmat a, b, c, ç, d, e dhe f) të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Brenda datës 31.12.2023 shoqëria TRUEN” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE miratimin me shkrim të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. për lirimin pa asnjë rezervë dhe asnjë kusht të kuotave të saj.
- Shoqëria “TRUEN” sh.p.k nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. e nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k.
2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. bëhet “YLLIAD” sh.p.k.
3. Brenda datës 31.12.2023, shoqëria “TRUEN” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE miratimin me shkrim të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a. për lirimin pa asnjë rezervë dhe asnjë kusht të kuotave të saj.

4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit nga ana e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. të kushtit të vendosur në pikën 3 të këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “TRUEN” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI